



Planuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	12.04.2022	2	viti god. year
Organ /Njësia Org./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	2023/2022		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.161/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.161/2022 të datës 23.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Prishtinë, kundër Vendimit KA.nr.06/2022 të datës 25.01.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 08.04.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.161/2022 e datës 23.02.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi KA.nr.06/2022 i datës 25.01.2022 i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

### A r s y e t i m

Ankuesi më datë 23.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 954/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit KA.nr.06/2022 të datës 25.01.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me pretendimin ankimor së i njëjti është nxjerrë më shkelje ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ( *tutje referuar Këshilli*) bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.03.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës (me tej

SKPK), ndërsa ky i fundit më datë 09.03.2022 ka dërguar përgjigjen në ankesë, se bashku me provat lidhur me çështjen.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 954/2022 të datës 23.02.2022; e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KA.Nr.06/2022 të datës 25.01.2022 të Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 03.03.2022; Përgjigjen në ankesë të datës 09.03.2022; Konkursin me numër reference KPA /ZKPSH/PA/PRSK/PTH/POY-018 i datës 04.11.2021 për pozitën Zyrtar Ligjor 2; Vendimin e datës 22.11.2021 për ndryshimin e Komisionit Përzgjedhës; Regjistrin e Aplikacioneve të Pranuar; Deklaratë për mos konflikt të interesit e datës 25.11.2021; Formularin për përcaktimin e kritereve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 25.11.2021; Formularin për përcaktimin e kritereve për testimin me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj i datës 25.11.2021; Formularin për vlerësimin individual për listën e ngushtë i datës 25.11.2021 dhe plotësuese e datës 26.11.2021; Lista përfundimtare e përzgjedhjes së listës së ngushtë e datës 25.11.2021 dhe plotësuese e datës 26.11.2021; Njoftimin e kandidatëve të përzgjedhur në listë e ngushtë i datës 25.11.2021; Regjistri i njoftimit për ardhje në testin me shkrim; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e testit me shkrim datës 03 dhe 04.12.2021; Regjistri i njoftimit për ardhje në intervistë; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e intervistës e datës 14.12.2021; Përmbledhja e vlerësimeve individuale e intervistës dhe testit me shkrim datës 14.12.2021; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 15.12.2021; Raportin final i rekomandimit nga Komisioni Rekrutues datës 15.12.2021; Njoftimin për përzgjedhjes përfundimtare i datës 16.12.2021; Testin me shkrim; *Aplikacioni për punësim i kandidatit* Diplomë nr.840 të datës 23.11.2019; Certifikatën për kryerjen e praktikës SKPK/DBNJ/NR.16 të datës 24.03.2021; Kontratë punë nr.16 për praktikë vullnetare; Letër referencë 2; Certifikatën nga Gjykata Themelore në Pejë e datës 19/08/2021; Letërnjoftimin e kandidatit *Aplikacionin për punë të kandidatës* Diplomën nr.4170 të datës 11.10.2016; Vërtetim Vr.1486/17 i datës 25.11.2017 nga OAK; Vërtetimin e datës 30.01.2019 nga *Vendimin me numër 1558/2016 i datës 26.11.2016; Letër motivim nga kandidatja* Pasqyrën e Llogarisë nga Trusti Pensional për periudhën nga 20.11.2002-03.04.2019; Certifikatën nga Gjykata Themelore në Gjilan e datës 09.11.2021; Letërnjoftimin e kandidatës *Aplikacionin për punësim të ankuesit: CV; Diplomë nr.00/18 e datës 19.07.2018; Kontratë nr.12/2021 për punë praktike vullnetare në Prokuroritë e Shtetit; Vërtetimin vr.nr.1298/2019 të datës 11.10.2019 nga OAK; Marrëveshje për shërbime të veçanta 04-052-2889 e datës 03.09.2019, Marrëveshje për shërbime të veçanta 04-052-1505 e datës 21.06.2019, Marrëveshje për shërbime të veçanta 04-052-1488 e datës 14.02.2020, Marrëveshje për shërbime të veçanta 4150 e datës 18.10.2021, Kontratë konsulentë 11-03/11 e datës 10.03.2011, Letër reference e datës 13.01.2020, Aneks kontratë 04-052-2134 e datës 30.06.2020, Certifikatën nga German Corporation e datës 10.11.2018, Certifikatë nr.licence LN-8372-08-2014, Certifikatën e Gjykatës Themelore në Prishtinë e datës 19.10.2019, letërnjoftimin e ankuesit; Ankesën e ankuesit e datës 13.01.2022.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e papabuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 04.11.2021 ka shpallur Konkursin e jashtëm me numër reference

KPA/ZKPSH/PA/PRSK/PTH/POY-018, për pozitën e punës *Zyrtar Ligjor 2*-dy pozita në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 14.11.2021 deri me datë 18.11.2021, ndërsa interesim konkurrimi kanë shprehur gjithsej 185 kandidatë duke përfshirë edhe ankuesin \_\_\_\_\_ i cili është përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit. Komisioni Përzgjedhës i themeluar me Vendimin me numër protokolli DPSKPK 398/2021 të datës 22.11.2021 të u.d Drejtorit të Përgjithshëm të SKP-së, përmes Raportit Final Form MAP-SHCK-11 si kandidatë të suksesshëm ka rekomanduar \_\_\_\_\_ më gjithsej 75.6 pikë dhe \_\_\_\_\_ me gjithsej 69.7 pikë. Konform këtij rekomandimi, Njësia e Burimeve Njerëzore të SKPK-së më datë 16.12.2021 ka publikuar Njoftimin për Përzgjedhjen përfundimtare duke shpallur si kandidatë të suksesshëm për pozitën *Zyrtar Ligjor 2* \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_

Ankuesi i pakënaqur me Njoftimin për përzgjedhjen përfundimtare, me datë 13.01.2022 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të SKPK-së, ndërsa ky i fundit përmes Vendimit me KA.nr.06/2022 të datës 25.01.2022, ka refuzuar ankesën e ankuesit dhe ka lënë në fuqi Njoftimin e datës 16.12.2021 për Përzgjedhjen përfundimtare të kandidateve të suksesshëm për pozitën *Zyrtar Ligjor 2* në Prokurorinë Themelore në Prishtinë sipas Konkursit të datës 04.11.2021.

Kundër vendimit të KZKA-së KA.nr.06/2022 të datës 25.01.2022, ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor së vendimi i kundërshtuar është nxjerrë më shkelje ligjore, duke shtuar se Komisioni Përzgjedhës nuk e ka vlerësuar drejtë në testin me shkrim dhe në intervistën me gojë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se në konkursin me numër reference KPA/ZKPSH/PA/PRSK/PTH/POY-018, të shpallur me datë 04.11.2021, si kriteret themelore të konkursit janë përcaktuar: *Diplomë universitare- Fakulteti Juridik dhe një vit përvojë pune profesionale.*

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit së Komisioni Përzgjedhës nuk e ka vlerësuar drejtë në testin me shkrim dhe në intervistën me gojë, Kolegji nga analizimi i testit me shkrim të ankuesit dhe bazuar në krahasimin e përgjigjeve me çelësin e testit, ka konstatuar së përmbajtja e testit me shkrim ka qenë në pajtim me nenin 36 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbim Civil, dhe se Kolegji nuk ka hasur në ndonjë parregullsië përkitazi me vlerësimin e saktësisë së përgjigjeve të dhëna dhe vlerësimin gjatë intervistës me gojë nga ana e Komisionit Përzgjedhës, kështu që në këtë kuptim rrjedhë së është i pa bazuar pretendimi ankimor si me lartë.

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës respektivisht sipas dokumentacionit të aplikimit ka konstatuar së kandidati i përzgjedhur \_\_\_\_\_ sipas Diplomës Nr.840 të datës 23.11.2019, ka përfunduar studimet më datë 06.07.2019, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka", duke marrë titullin Jurist i diplomuar/Bechelor, ndërsa lidhur me kriterin e përvojës së punës pa diplomimit, i njëjti sipas Certifikatës SKPK/DBNJ/NR.16 të datës 24.03.2021 dhe Kontratës Nr.16 ka punuar si praktikant në Prokurorinë Themelore në Pejë nga data 04.09.2019 deri 03.09.2020 dhe nga data 01.10.2020 deri 19.03.2021, ndërsa kandidatja e dytë e përzgjedhur \_\_\_\_\_ sipas Diplomës Nr.4170 të datës 11.10.2016, ka përfunduar studimet më 16.04.2016, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", duke marrë titullin Jurist i diplomuar/Bechelor, kurse lidhur me përvojën profesionale pas diplomimit gjegjësisht nga Vërtetimi Vr.1486/17 i datës 25.11.2017 e njëjta ka kryer praktikën e avokatisë tek avokat Jusuf Mejzini në Prishtinë në kohëzgjatje prej 26.11.2016 deri me 25.11.2017, si dhe sipas Vërtetimit të

datës 30.01.2019 ka punuar në zyrën e avokatit Ilir Ramaj në cilësi të bashkëpunëtores profesionale nga data 03.01.2018 deri 31.12.2019. Po ashtu nga vlerësimi i dokumentacionit të aplikimit rrjedhë se edhe ankuesi ka plotësuar kushtet e arsimit dhe përvojës së punës, dhe se mbi këtë bazë Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në mënyrë të drejtë ka vlerësuar aplikacionet e ankuesit dhe kandidatëve të përzgjedhur, duke vepruar në pajtim me nenin 28 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve si në vijim: 1.1arsimimi dhe kualifikimi profesional, përvoja e punës, shkathtësia dhe aftësitë dhe elementet e tjera të meritë.* Mirëpo Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në bazë vlerësimit përfundimtar të Komisionit përzgjedhës ka konstatuar së kandidati Fisnik Shala është vlerësuar si kandidati i parë me gjithsej 75.6% pikë, kandidatja Eglentina Sahiti është vlerësuar si kandidati i dytë me 69.7%, ndërsa ankuesi është vlerësuar si kandidati i njëzeteshtatë me gjithsej 51.5% dhe si rrjedhojë Kolegji vlerëson se Komisioni Përzgjedhës ka vepruar në pajtim me nenin 40 paragrafin 1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku parashihet se: *Në Shërbimin Civil emërohen kandidatët, të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë”.*

Kolegji nga shqyrtimi i provave material verën se ka pas tejkalim të afateve procedurale përkitazi me përgatitjen e listës së shkurtër dhe testim të kandidatëve për shkak të numrit shumë të madh të kandidatëve /aplikuesve, mirëpo Kolegji një të gjetur të tillë nuk e vlerësoj si shkelje esenciale procedurale gjegjësisht sipas gjykimit të Kolegjit kjo e gjetur nuk ka cenuar ligjshmërinë e procesit rekrutues apo të ketë mohuar në ndonjë formë të drejtat e kandidatëve në procedurë konkurrimi.

Nisur nga konstatimet si me sipër, Kolegji vlerëson se procedura e rekrutimit për pozitën e lartcekur është zhvilluar në pajtim në pajtim me nenin 3 paragrafi 9 dhe nenin 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës, si dhe dispozita e Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KA.nr.06/2022 të datës 25.01.2022 ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.161/2022

Avdyl BEKTESHI

*Bektashi*  
Procesmbajtës

Ardita Haxhiqaj-DEMI

*Ardita*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

